


KËRKESË ANKIMORE

Drejtuar: Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve

Adresa: Rruga "Ibrahim Rugova", Ndërtesa nr.4, Tiranë



08/16.45

ANKUESI	Partia Socialiste e Shqipërisë Adresa: Sheshi "Austria" nr.91, 1000, Tiranë Nr.tel

OBJEKTI I ANKIMIT

KUNDËRSHTIMI I VENDIMIT TË KOMISIONERËIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE

Vendimi

Nr. 455, Datë 6.05.2023

TITULLI I VENDIMIT

"PËR SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT NR. 386 NGA SUBJEKTI "KOALICIONI PËR REFORMA, INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË KONSOLIDUARA" (KRIIK) PËR AFISHIMIN E MATERIALEVE PROPAGANDISTIKE NË KUNDËRSHTIM TË LIGJIT NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR "PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË" NË AKSIN RRUGOR KOMBËTAR TIRANË – LUSHNJE".

BAZA LIGJORE

Neni 124/1 pika 2 e ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe dhe vendimi nr.3, datë 06.11.2020, i Komisionit Rregullator, "Për miratimin e rregullores "Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve"

PËRSHKRIMI I SHKELJES SË PRETENDUAR

- Referim i gabuar i bazës ligjore:** Në vendimin e lartpërmendur Komisioneri bazohet në nenin 79, pika 2 të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar i cili përcakton detyrimin për përdorimin dhe afishimin e materialeve propagandistike "...vetëm në një largësi prej 5 metrash nga zyra zgjedhore e partisë politike apo subjektit zgjedhor përkatës." Njëkohësisht, në paragrafin 6 të vendimit të lartpërmendur, Komisioneri konstaton "...pas verifikimit të të dhënave, provave dhe fakteve të bëra nga denoncuesi..." se "...materialet propagandistike janë vendosur në kundërshtim me nenin 3, pika 1, të udhëzimit nr. 6, datë 23.3.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore". Ndërkohë, në paragrafin 3 të këtij vendimi Komisioneri pohon se pas



Kërkesë ankimore

denoncimit të kryer ka nisur hetim administrativ. Në kuadër të hetimit administrativ, monitoruesit të caktuar nga KQZ për monitorimin e bashkive Lushnje, Rrogozhinë, Kavajë dhe Durrës i është kërkuar informacion i mëtejshëm. Nga ky informacion ka rezultuar “...se materialet propagandistike janë të vendosura në këto akse rrugore dhe nuk përmbajnë shënimin “prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të...””. Sikurse mund të konstatohet, ekziston një paqartësi për shkak të mospërputhjes së shkeljes së pretenduar dhe bazës ligjore, të përdorur nga Komisioneri, për të bazuar këtë vendim. Për pasojë edhe vendimet e mëtejshme të Komisionerit, në të cilat urdhërohet Policia Bashkiake dhe Policia e Shtetit për heqjen e materialeve propagandistike në aksin rrugor kombëtar Tiranë – Lushnje, janë të bazuara në një vendim jo në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. **Vendim i pabazuar në fakte:** Nisur nga denoncimi i kryer, sipas të cilit “Në aksin rrugor kombëtar nga Tirana në Lushnjë, përkatësisht në bashkitë Lushnjë, Rrogozhinë, Kavajë janë afishuar materiale propagandistike në kundërshtim të ligjit nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” Komisioneri ka zhvilluar hetimin administrativ në përfundim të të cilit ka konstatuar se materialet propagandistike të vendosura në këto akse rrugore “...nuk përmbajnë shënimin “prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të...””. Për pasojë, Komisioneri ka urdhëruar heqjen e këtyre materialeve. Ky vendim është bërë në shkelje të procedurave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, duke iu referuar fakteve jo ekzistente dhe cënuar të drejtat që subjektet zgjedhore kanë, gjatë fushatës, në kuadër Kodit Zgjedhor (më konkretisht neni 78).



FAKTET, ARGUMENTAT, DISPOZITAT LIGJORE KU MBËSHTETET ANKIMIMI.

1. Presidenti Republikës së Shqipërisë, me Dekretin Nr.13864, datë 24.10.2022 ka caktuar datën 14 Maj 2023, për zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore ne vendin tonë.
2. Kodi Zgjedhor i RSH, i ndryshuar, ka parashikuar rregulla mjaft të qarta për përgatitjen, zhvillimin dhe administrimin e zgjedhjeve në vendin tonë duke u ndërtuar mbi bazën e parimeve të shtetit të së drejtës, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe shumë të drejtave të tjera të mbrojtura nga Kushtetuta.
3. Subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë (P.S.SH) garon në këto zgjedhje vendore në të gjitha zonat zgjedhore të vendit tonë ku përfshihen konkretisht edhe Bashkitë Durrës, Rrogozhinë, Kavajë dhe Lushnjë.
4. Neni 78 pika 1 i Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, përcakton se gjatë fushatës zgjedhore cdo subjekt zgjedhor ka të drejtë të bëjë propagandë zgjedhore në cdo mënyrë të ligjshme.
5. Neni 79 i Kodit Zgjedhor përcakton rregullat për afishimin e materialeve propagandistike të cilat, sipas pikës 31 të nenit 2 të Kodit, janë materiale që i shërbejnë subjektit për promovimin e fushatës zgjedhore dhe që *“... janë vendosur ose afishuar në vende ose hapësira publike me akses publik... përgjatë rrugëve ndërqytetëse etj”*.
6. Në përputhje me dispozitat e lartpërmendura, dhe në respektim të legjislacionit në fuqi, Partia Socialiste e Shqipërisë ka nënshkruar marrëveshje kontraktuese, me subjekte që operojnë në këtë fushë, për të afishuar postera reklamues ndër të cilat bëjnë pjesë edhe posterat objekt i vendimit nr.455, datë 6.5.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Për rrjedhojë, duhet theksuar që vendet për vendosjen e tyre nuk janë përfituar në kuadër procesit të shpërndarjes proporcionale të bërë sipas përcaktimeve të nenit 79 të Kodit Zgjedhor si dhe të udhëzimit nr.6, datë 23.3.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, *“Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”*.
7. Në vendimin nr. 455, datë 5.5.2023, me objekt kërkesën për *“...heqje e menjëhershme e materialeve propagandistike në kundërshtim të ligjit në aksin rrugor kombëtar nga Tirana në drejtim të Lushnjes”*, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve merr në shqyrtim denoncimin e bërë nga Koalicioni për Reforma, Integritim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK) dhe fillon një hetim administrativ për të verifikuar shkeljen e pretenduar.
8. Në paragrafin nr.3 të vendimit theksohet që në kuadër të këtij hetimi *“...monitoruesit të caktuar nga KQZ për monitorimin e bashkive të sipërcituara, nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, ju kërkua informacion në lidhje me afishimin e këtyre materialeve propagandistike nëse vazhdojnë të jenë akoma të afishuara.”* Komisioneri pohon se nga informacioni i kërkuar *“...rezultoi se materialet propagandistike janë të vendosura në këto akse rrugore dhe nuk përmbajnë shënimin “prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të...”*”.
9. Në paragrafin 6 të vendimit vlerësohet se *“Pas verifikimit të të dhënave, provave dhe fakteve të bëra*



nga denoncuesi, si dhe raportit të monitorimit...materialet propagandistike janë vendosur në kundërshtim me nenin 3, pika 1, të udhëzimit nr. 6, datë 23.3.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore".

10. Sikurse do të evidentohet edhe në dokumentet bashkëlidhur kësaj ankese, në posterat reklamues (të afishuara sipas procedurës së shpjeguar në pikën 5 më lart), është vendosur shënimi në përputhje me përcaktimin e pikës 3 të nenit 79 të Kodit Zgjedhor, i ndryshuar, si dhe të pikës 1 të nenit 3 të udhëzimit të lartpërmendur. Vlerësojmë se Komisioneri, gjatë shqyrtimit të denoncimit të bërë dhe informacioneve të mbledhura nga monitoruesi i caktuar nga KQZ, nuk ka kryer verifikimin e nevojshëm dhe për pasojë faktet e përdorura për të bazuar vendimin dhe konstatuar shkeljen e pretenduar nuk përputhen me realitetin.
11. Për më tepër, vlerësojmë se ky vendim humbet legjitimitetin e tij për shkak të referimit të gabuar të bazës ligjore në të cilën mbështetet evidentimi i shkeljes së pretenduar. Duke u referuar në pikën 2 të nenit 79 të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, si dhe në pikën 1 të nenit 3 të udhëzimit nr. 6 të lartpërmendur, Komisioneri i referohet një shkelje të ndryshme nga ajo të cilën pretendon se ka evidentuar.
12. Subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, pasi u njoh me vendimin Nr.455, datë 6.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve Sarandë, në bazë të nenit 70 të Kodit Zgjedhor të R.SH, të ndryshuar, të Rregullores "Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve" të ndryshuar, miratuar me vendimin Nr.3/2020 të K.RR nuk është dakord me vendimin në fjalë dhe parashtroi kundërshtimet e tij.



Kërkese ankimore

1. Vendimi nr.455 , datë 06.05.2023
2. Fotot e posterave reklamues


ERIDIAN SALIAJI





08 / 05 / 2023

Kërkesë ankimore












Produar nën përgjegjësinë ligjore të Partisë Socialiste të Shqipërisë











Prodhuar nën përgjegjësinë Ilgjore të Partisë Socialiste të Shqipërisë









DEKLARIM

176

SHAN S

Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të Partisë Socialiste të Shqipërisë






BELIND

176

SHKAM S


Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të Partisë Socialiste të Shqipërisë






















PËRPARA


VETËM





































BEHIND

SHANS

Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të Partisë Socialiste të Shqipërisë



Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të Partisë Socialiste të Shqipërisë



Materiale: çelik (30 mm)
 Prezantimi i Fotot: printuar mbi çelik të zinkuar
 Ngjyra: e zezë pa shkëlqim, Ral 9004
 Fiksimi: realizohet me filetim me anë të bulonave prej çeliku të zinkuar mbi kalldrëm




Elemente turistikë - kulturore informuese (V3) Skemë Teknike 14



Prodhuar nën përqëqjësinë Ilgjore të Partisë Socialiste të Shqipërisë

F

Produktet në përqjesinë ligjore të Partisë Socialiste të Shqipërisë



Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të Partisë Socialiste të Shqipërisë









